

FATOS KONGOLI
ËNDRRA E DAMOKLEUT
ROMAN

BOTIMET TOENA

Fitues i Çmimi Letrar
“Balkanika - 2002”

FATOS KONGOLI

ËNDRRA E DAMOKLEUT

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-89-3

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: info@toena.al

botimet.toena@gmail.com

<https://www.toena.al>

Facebook: Botimet Toena

Instagram: [botimet_toena](#)

Prolog

Tre vjet të shkuara, në vjeshtë '97, R. G. vrau veten. Në atë klimë katrahurash kjo, doemos, nuk ishte një ngjarje e jashtëzakonshme. Edhe sot e kësaj dite, për lexuesin – nëse ky libër do të ketë një lexues – vrasja, me çfarëdo lloj motivi – sipas buletineve zyrtare në pjesën dërrmuese motivet klasifikohen me cilësimin e rëndomtë “të dobëta” – bën pjesë në gjërat e zakonshme të jetës. Pavarësisht cilën gazetë ose kanal televiziv parapëlqejnë, njerëzit do të gjejnë kudo kronikën e vrasjeve të ditës. Nëse për një arsye ose një tjetër nuk e gjejnë, ata nuk ndihen mirë, i pushton një pakënaqësi e ngjashme me pakënaqësinë e atij që është mësuar të lexojë rregullisht horoskopin dhe gazeta apo kanali televiziv në fjalë e kanë harruar. Në këto kushte

një vetëvrasje nuk habit njeri. Edhe unë, duke kujtuar vetëvrasjen e zotit R. G. nuk mëtoj të habit njeri.

Arsyet që më shtyjnë të tërheq vëmendjen sadopak rreth këtij rasti lidhen me një detyrim, po e quaj moral. Vetëvrasja ndodhi në shtëpinë time, në njërën nga dhomat e apartamentit ku banoj, të cilën ia kisha lëshuar me qira viktimës. Meqë ra fjala, nuk e di, është apo nuk është e drejtë të përdoret këtu fjala viktimë. Fatkeqët, që vendosin ta zgjidhin nëpërmjet vetëvrasjes kontradiktën e tyre me veten apo me botën, ndoshta me të dyja bashkë, janë viktima. Por nëse kjo nuk qëndron, nëse ngjall kundërshtime, unë tërhiqem.

Tekefundit, për mua termat s'kanë fort rëndësi. Me termat merren specialistët dhe unë nuk jam ndonjë specialist. Siç vura në dukje, jam thjesht dëshmitar i një vetëvrasjeje. E ajo u krye një ditë në njërën nga dhomat e apartamentit tim. Kësaj rrethane i shtohen pastaj rrethana të tjera më thelbësore.

Për mua R. G. nuk ishte një qiramarrës i zakonshëm. Ai nuk erdhi tek unë vetëm sepse midis një morie lajmërimesh zgjodhi variantin tim. Pra, në këtë mes rastësia nuk hyn. R. G. e njihja e më njihte. Për të unë isha një mik i vjetër i të atit, për mua ai ishte djali i vetëm i një miku të hershëm. Në këtë pikëpamje ndihem dyfish i ngatërruar, edhe me të atin,

edhe me të birin, me një fajësi të pashlyeshme, që më rëndon në shpirt.

Kur R. G. vrau veten unë ndodhesha në klubin pranë pallatit, po pija një gotë. Njëri nga fqinjët mbërriti me vrap, më kërkoi ta lija pijen, në apartamentin tim ishte ndier një krismë revolveri, pra diçka duhej të kishte ndodhur. Të them të drejtën në fillim nuk i dhashë rëndësi. S'kisha përse t'i jepja rëndësi. Shkrehje armësh dëgjoheshin gjithandej, natën e ditën, dhe mund të qe vetëm një përshtypje e fqinjit sikur krisma vinte nga apartamenti im. Nuk u shqetësova edhe për një arsye tjetër më bindëse: kur isha larguar para rreth një ore nga shtëpia, R. G. e kisha lënë në dhomën time të punës. Ai rrinte aty pothuajse nga mëngjesi në mbrëmje, shtypte diçka në makinën e shkrimit e kjo vazhdonte prej nja dhjetë ditësh. Me gjithë disa probleme të gjendjes së tij psikike ndonjëherë të dyshimtë, asnjë sjellje e atyre kohëve nuk më bënte të mendoja se në të vërtetë ai po linte një lloj testamenti, një fjalë të fundit para se të ndahej nga kjo botë.

Trupin e R. G. e gjetëm në dhomën e tij. Ai ishte vetëvrarë mbi krevat dhe unë e mbylla derën menjëherë, sapo e pashë nga larg të shtrirë, të mbytur në gjak. Policia mbërriti shpejt, nja dhjetë minuta pas telefonatës sime. Qëndrova në korridor edhe kur një numër civilësh dhe uniformash blu, po të huazoj një

shprehje gazetash, u futën në dhomë, u morën me të vetëvrrarin aq sa e panë të nevojshme për të mbledhur çdo provë materiale, midis të cilave një pistoletë, prodhim kinez sipas modelit rus TT. Ekspertët më bënë të ditur, jo pa habi, se s'kishin gjetur asgjë të lënë me shkrim, qoftë një pusullë sado të shkurtër.

– Zakonisht, – m'u ankua njëri prej tyre, – të vetëvrrarët lënë diçka në formë sqarimi për aktin, shfaqjesim ose akuzë, e kjo na ndihmon shumë për zbardhjen e çështjes. Mirëpo ky djalosh duket s'ka dashur të lërë asgjë, i ka marrë të gjitha me vete.

Ngrita supet. Dhe për pak këputa një marrëzi.

– E ke gabim, – desha t'i them, – është e pamundur të mos gjenden fakte materiale të shkruara. Prej dhjetë ditësh viktima daktilografonte diçka në makinën time të shkrimit e kjo me siguri duhej të gjendej diku.

Intuita më ndihmoi të mos e bëja këtë marrëzi. Pra vetëm ngrita supet, e kyça gojën dhe qëndrova i heshtur në korridor, derisa ata mbaruan punë, kontrolluan dhe fotografuan vendin e ngjarjes bashkë me kufomën. Në fund trupin e tërhoqën mbi një barelë, ekspertët dyllosën derën e dhomës dhe u larguan. Sigurisht, puna nuk mbaroi me kaq. M'u desh të paraqitesha kohë më kohë sa herë që një hetuesi të çështjes i mbushej mendja të më merrte në pyetje. Kjo është një histori e mërzitshme, nuk ia vlen të zgjatem. Pastaj,

sidoqoftë, mbërriti një çast kur ekspertët e gjykuan të arsyeshme mbylljen e çështjes. Gjithçka fliste për një vetëvrasje të pastër klasike, në kushte të rënduara mendore e unë u lashë i qetë.

Tani, pas tre vjetësh, më duhet të bëj një rrëfim. Dëshmitë e mia në hetuesi gjatë periudhës gati dymujore, aq sa u desh të arkivohej çështja, qenë të ndershme përveç një pike ku gënjeva me ndërgjegje të plotë. Kjo lidhet me dëshminë e shkruar. Unë këmbëngula në gënjeshtren se viktima s'kishte lënë asgjë të shkruar, këtë e vërtetoja nëpërmjet fqinjit. Në çastin kur hapëm derën e dhomës dhe pamë të dy tutje mbi krevat të vetëvrrarin, asnjëri nga ne nuk u fut brenda. Deri këtu gjithçka ishte krejt e vërtetë. Gënjeshttra ime nis pas largimit të ekspertëve, kur mbeta vetëm dhe zura të dyshoja. Jo, miku im, thashë me vete, ti s'mund të jesh larguar kështu, s'është në stilin tënd. Dhe hyra në dhomën time të punës. Makina daktilografike ndodhej në vendin e saj, mbështjellë me këllëfin prej doku kundër pluhurave. Mbi tryezë nuk gjendej asnjë fletë e bardhë ose e shkruar. Në kosh, asnjë copë letër e zhubrosur. Atë që kërkoja e gjeta në dollap, midis një shtresimi dosjesh. Qe vendosur enkas në mënyrë të tillë që të më binte në sy. Ishte një dosje e vjetër, nga ato prej kartoni të trashë me lidhëse.

Më poshtë po i paraqes lexuesit përmbajtjen e kësaj dosjeje. Më duket i panevojshëm çdo koment paraprak, çdo orvatje për ndonjë sqarim, mënyrën sesi është shkruar. Kështu do të fyeja kujtimin e të ndjerit. Ndoshta mund të jetë me interes një saktësim. Në dëshminë e tij R. G. ka parapëlqyer të mos shfaqet me emrin e vërtetë. Kjo më shtyn të ngre një varg hipotezash e, mbi të gjitha, një hipotezë të dhimbshme rreth lëkundjeve dhe paven-dosmërisë për një kohë të gjatë të të ndjerit lidhur me vetëvrasjen. Sa u përket lojtarëve të tjerë, një pjesë e mirë e të cilëve të njohur për mua, jepen me emrat e tyre të vërtetë.

Vendimin për ta paraqitur këtë dosje, nuk e mora brenda një çasti. M'u deshën tre vjet të vendosja. Të kapërceja ngurrimet, skrupujt e moralit të pranuar publik. Të marr parasysh rreziqe të pritshme. Po kush mund të thotë sot këndeje, nga viset tona të arbitrit, se nuk ndihet i zbuluar ndaj çdo lloj rreziku?

1

Njerëzve nuk u intereson më asgjë. Mbase kështu ka qenë gjithmonë, në çdo kohë, në jetë të jetëve dhe duke bërë këtë pohim unë përsëris diçka të stërnjohur. Më vjen keq, qëllimi im nuk është të mërzis askënd. Dua vetëm të thyej ndonjë xham. Pastaj të nxjerr kokën në dritare, t'ia jap ulërimës. Mirëpo kjo është e tmerrshme. Më bën të ndihem qysh në fillim i humbur sepse pa dashje, qysh në fillim, po krijoj një ide të gabuar rreth vetes. Unë e di ç'nofkë do t'i vinin një njeriu me ngasje për të thyer e ulërirë e deri këtu do të ishte gjysma e së keqes. Nuk shqetësohem po të më quajnë të çmendur, nuk është as turp, as diçka e rrallë të jesh i çmendur. Çështja është se në kokën time ndodh një ngatërrësë, s'jam i sigurt nëse

jetoj një realitet të vërtetë apo ngjarjet i përkasin një të shkuare, kam mbetur brenda tyre e nuk shqitem dot. Siç mbetet një mizë në fijet e merimangës.

Më rrethojnë dy gjëra, përkujdesjet dhe heshtja. Gjatë ditës, nga mëngjesi në mbrëmje, heshtjen vërtet e prishin në mënyrë alternative kambanat e një kishe, kënga e një hoxhe e transmetuar me altoparant nga minarja e një xhamie dhe natën, fill pas vendosjes së ndalim-qarkullimit të gjendjes së jashtëzakonshme, krismat e kallashnikovëve. Por unë e kam fjalën për tjetër heshtje, atë të frikshmen, të njerëzve. Këto rrethana vënë në dyshim natyrën reale të gjendjes sime brenda gjendjes së jashtëzakonshme të shoqërisë. Dua të them statusin që më kanë caktuar e këtu kam parasysh llumin moral, i cili, pasi kalon nëpër një numër filtrash okultë, përfundon në lentin e mjekëve dhe policisë. Këta, nga ana e tyre, shpallin se cilët pjesëtarë të shoqërisë konsiderohen normalë, cilët damkosen me vulën e rrezikshmërisë shoqërore, cilët përfshihen e cilët përjashtohen, cilët mbahen mbyllur në burgje e cilët nëpër çmendina. Në rastin tim kjo nuk paraqet rëndësi. Prej kohësh unë kam patur punë edhe me policinë, edhe me mjekët, por nuk jam mbyllur ndonjëherë as në burg, as në çmendinë. Sa më shumë e vras mendjen, sa më fort torturohem për formulimin e një shpjegimi të arsyeshëm të

statusit ku ndodhem, aq më e qartë bëhet për mua se gjithçka është shprehje e pakundërshtueshme e gjendjes sime edhe në burg, edhe në çmendinë.

Ja, përsëri rashë brenda me këmbët e mia, siç bie miza në rrjetën e merimangës. Por më duket se jam shumë i kthjellët. Pavarësisht lajthitjes, pohoj pa mëdyshje se burgu dhe çmendina ime njëherazi aktualisht është shtëpia e tim eti. Për të shmangur një ngatërresë të mundshme kohësh, po them: ishte dhe është shtëpia e tim eti.

E kam fjalën për shtëpinë e re, koordinatat e së cilës dëshiroj t'i mbaj të fshehura.

Nja shtatë-tetë muaj më parë ne u grindëm keq, dua të them unë dhe im atë. U largova nga shtëpia, më e saktë është të thuhet më përzuri ai, të mos e shkelësh më këtë prag, më tha, shtoi se i vinte ndot prej meje, i vinte turp, e unë u largova i errur, pa asnjë ide se ku do të shkoja, mjafton t'i ikja prepotencës së tij imperiale. Atëherë ne banonim ende në një apartament diku në një pallat nga zona e Varrit të Bamit dhe gjatë atyre muajve të një moskomunikimi të plotë unë s'mora vesh asgjë rreth tij, ndoshta dhe ai rreth meje.

Kjo e fundit ka të ngjarë të mos jetë e vërtetë. Ndryshe nuk ka si shpjegohet që pas një humbjeje të vetëdijes, me të hapur sytë, fytyra

e parë që m'u shfaq ishte ajo e njerkës sime, e unë e kuptova ku ndodhesha. Por kisha kuptuar vetëm një pjesë të së vërtetës, kjo nuk ishte shtëpia e fëmijërisë, ishte një vilë me tri dhoma e një banjë në katin përdhes, po aq në katin sipër ku gjendesha unë, i rrethuar nga komforti, nga një heshtje e thellë e përhershme dhe pothuajse gjatë gjithë kohës nga përkujdesjet e njerkës.

Në këtë pikë e shoh të nevojshme të hap parantezën e parë. Kjo lidhet me Dizin, kështu quhet njerka ime. Qëllimi i kësaj paranteze nuk është thjesht të hedh poshtë çdo përfytyrim të gabuar tradicional që ka të ngjarë të krijojë fjala njerkë. Dizi është grua e bukur, e re, nja njëzet vjet më e re se im atë, me lëkurë të bardhë e tipare të zeshkëta, flet me zë të ulët si të ketë frikë se mos bezdisë njeri. Kur hapa sytë dhe e pashë sipër meje, desha t'i ulërija (përsëri ulërimë...!), t'i thosha të largohej, të më linte të qetë. Kur hapa sytë dhe vura re në sytë e saj pika loti, desha ta pyesja ç'i kishte ata lot. I vinte keq për Lindën, i vinte keq për mua apo për veten e kështu kërkonte të çlirohej nga brejtja e mëkatit. Po ndoshta në çastin e rikthimit të vetëdijes ajo m'u shfaq jo për të më kujtuar ndonjë mëkat të saj. U shfaq të më kujtonte mëkatin tim, për pasojë ndëshkimin tim.

I gjithë trupi më therte. Pata përshtypjen se brenda kafkës më pluskonte një përzierje

si llavë vullkanike. Dhembjet dëshmonin realitetin, domethënë unë vazhdoja të jetoja dhe rruga për te Linda më qe mbyllur. Në fillim, për shkak të një ere ilaçesh dhe një mbajtësi metalik me serum aty pranë, dyshova mos ndodhesha në spital. Këtë ma përforcuan edhe fashat e mbështjella në kokë. Vetvetiu ngrita dorën, i preka pa mundur të kuptoja asgjë, si ndodhesha këtu e për ç'arsye me kokë të fashuar. Mbaja mend vetëm një shkrepimë në dy pikat e kundërta të një segmenti të errët midis zgjimit tim dhe çastit të fundit para humbjes së vetëdijes. Pastaj mezi i rashë në të se shtrati, dhoma, sendet përreth, pikturat e varura në mure, tepër familjare për mua, një televizor i vendosur matanë, e hidhnin poshtë idenë e një dhome spitali. Ndodhesha diku tjetër ku, veç pikturave, çdo gjë ishte e huaj, po të mos përmend fytyrën e Dizit. Isha i këputur, nuk gjeta forca të pyesja së paku ku ndodhesha, një trullosje më përpiu sërish, një rënie në boshllëk dhe më bëri përshtypje se kësaj radhe nuk dëgjova krisma. Duket njerëzit kishin hequr dorë nga shkrehjet e armëve dhe unë, i lehtë si një pupël pëllumbi e rrëmbyer nga era, ndjeva qartë se po humbisja në pavetëdije e ndoshta do ta gjeja shtegun për të vajtur te Linda.

Nuk qe e thënë, i hapa sytë përsëri. Sipas Dizit kjo ndodhi pas një kllapie të re, që zgjati njëzet e katër orë. Unë përsëri pata përshtypjen

se brenda kafkës më pluskonte një përzierje si llavë vullkanike, trupi më therte, fashat ma shtrëngonin kokën si pranga. Dhe më shqetësonin dy gjëra: një marrje në pyetje nga mjekët ose një marrje në pyetje diku, në ndonjë komisariat policie. Mbaja mend qartë se kisha dashur të kryeja një vrasje. Pa pikë dyshimi... Po ndoshta dëshirat e mia vrastare mund të kishin mbetur në trajtën e dëshirave, me gjithë vendosmërinë time unë s'kisha mundur të realizoja ndonjë vrasje. Një gjë më kujtohej me siguri: revolveri i prodhimit kinez sipas modelit rus TT. Ia kisha blerë një romi në një qoshe të "Pazarit të Gabit", që ato ditë marsi ishte boshatisur. Askujt nuk ia mbante të dilte, të shiste apo të blinte mallra. Unë dola, unë s'kërkoja këpucë të përdorura apo mbathje me prejardhje të vdekurish. Unë kërkoja një send tjetër, ai gjendej me shumicë, ta ofronin me çmim të arsyeshëm dhe unë e bleva lirë, në një qoshe të "Pazarit të Gabit". Këtë e mbaj mend mirë, siç mbaj mend se u enda rrugëve i armatosur, me karikatorin e armës të mbushur plot e më tej s'di ç'u bë, e përdora apo jo, e humba rastësisht apo ma vodhën, apo thjesht e fsheha gjëkund e tani e kam harruar s'di se ku.

Urgjenca ime e parë është të sqaroj në kam vrarë njeri apo jo. Nëse kam vrarë, kjo duhet të merret vesh botërisht, unë s'pranoj të jem

vrasës i rëndomtë, një grabitës rrugësh, terrorist me maskë të zezë, pra kërkoj gjyq të rregullt. Me këtë rast të kthehem nga i akuzuar në akuzues. Planin e mbrojtjes vetjake, pa nevojën e një avokati mbrojtës, e kam përpunuar në hollësi. Unë s'kam nevojë për mbrojtje. Dua të them të vërtetën time. Vetëm kaq.

2

*S*m atë erdhi të më shihte pasi dola nga kllapia e dytë. Ai u shfaq te dera e dhomës me trupin e madh dhe në një pjesëz të sekondës, aq sa e mbajta vështrimin tek ai, më ra në sy kërrusja e shtatit të tij, një prishje në fytyrë, një përthithje e tipareve, ku s'kishte asgjë nga ajo vendosmëria e përhershme e njeriut të sigurt në veprimet e veta. Këto i hetova brenda një çasti të shkurtër, pastaj mbylla sytë, i vendosur të mos i hapja. Nuk e di nëse e vuri re ai apo jo këtë veprim timin. U afrua ngadalë te koka e krevatit, pranë karriges ku zakonisht rrinte Dizi, por nuk u ul. Ra një qetësi e thellë gjatë së cilës unë qëndrova si i vdekur duke ndier rrahjen e zemrës sime dhe frymëmarrjen e tij. Më në fund ai e theu heshtjen.

– E di, – tha, – nuk po fle, mos u shtir...

Vijoi një heshtje tjetër po aq e gjatë, të cilën im atë e theu përsëri me zë të mbytur.

– Më vjen sinqerisht keq për ty, – tha, – duhet të më besosh, unë nuk e uroja kurrë atë që ndodhi. Ti mund të më kishe lajmëruar dhe çdo gjë do të kishte vajtur ndryshe... Të lutem të më besosh, më vjen keq, shumë-shumë keq... Ajo që ndodhi është vërtet e tmerrshme dhe të gjithë ne jemi të tronditur...

Mua po më buçisnin tëmthtat. Diku në kraharor apo në pavetëdije m'u ndez një xixë. U çlirua, u zmadhua, zuri të vinte rrotull në formë lëmshi brenda kraharorit e brenda kafkës, kërkonte të dilte jashtë, të shpërthente, e kjo do të thoshte t'i ulërija tim eti. Por ai s'duroi gjatë, u largua dhe unë hapa sytë. Nuk më lejohej ta lëshoja veten. Në rrethanat e dhëna duhej t'u jepja përgjigje një mijë pyetjeve, së pari më elementares: ku gjendesha?

Më sqaroi Dizi. Ajo u fut në dhomë fill pas largimit të tim eti, e zbardhur në fytyrë dhe unë vendosa ta shfrytëzoja pështjellimin e saj të shumëfishtë. Sapo zuri vend në karrigen pranë meje lëvizta, u ngrita përgjysmë në krevat, e zura nga dora dhe me një zë të ulët që urdhëronte bashkëfajësi, i kërkova të më sqaronte ç'doja këtu, kush më kishte sjellë, përse më mbanin të izoluar.

E zënë në befasi Dizi vështroi nga ballkoni, sikur prej andej, në mes të ditës, të ishte

derdhur në dhomë e të ishte përplasur në timpanet e veshëve të saj një buçimë kallashnikovësh. Por, në atë orë ishte ende shpejt për kallashnikovë. Rreth e rrotull armët prisnin të ngrysej. Me t'u errur ato shfaqeshin, i përgjigjeshin njëra-tjetrës si qentë nëpër natë, këndonin apo vajtonin, nuk merrej vesh, vetëm villnin zjarr, njerëzit strukeshin me frikën e vdekjes në bark. Dizi më hodhi një vështrim të trembur si të kishte edhe ajo frikën e vdekjes në bark.

Ia lëshova dorën, u shtriva përsëri. Ndoshta ngaqë atë çast më përshkoi një dridhmë: ishte zëri i Lindës. Më pëshpëriste në vesh, më kërkonte të flija, e vetmja mënyrë për t'u takuar bashkë. Unë s'mund të mos i bindesha. Dhe s'mund ta përmbaja një gulsh që më zuri fytin. Ndërsa Dizi, gjithnjë në karrigen pranë meje, tek përpiqesha të zhytesha për të shkuar te Linda, më bëri të ditur se këtu s'duhej t'i trembesha asgjëje, ndodhesha në vend të sigurt, në shtëpinë time, ishte e tëra në dispozicionin tim, një vilë me kopsht e garazh veture, të cilën im atë e kishte blerë katër muaj të shkuara vetëm për mua!

Lajmi duket e trembi Lindën, s'po e dëgjoja më zërin e saj, as yshtjen për të fjetur, çka donte të thoshte se s'do të mund ta takoja. U mbusha me një mëri të re, kësaj radhe ndaj Dizit. Sapo kisha marrë nga Linda një ftesë

për takim, kurse ajo më njoftonte se qenkësia trashëgimtar i një vile të blerë posaçërisht për mua. Linda nuk ndodhej e pranishme të merrte vesh ç'bëhej. Po të ndodhej, ajo do të kërcente përpjetë nga gëzimi, siç doja unë të kërceja përpjetë nga një ngasje e kundërt, një tërbim për t'iu hedhur dikujt në fyt.

Atë çast shkrepiti. Një bubullimë e fortë drodhi muret e dhomës, e gjithë shtëpia u tund. Dizi vazhdoi të qëndronte pranë meje e zbehtë. Gjatë atyre muajve ajo ishte shëndoshur, duket nuk e çante më kokën të ruante linjat. I sulmuar nga aroma e trupit të saj mendova se më mbeteshin dy rrugë: t'i thosha të zhdukej, të mos shkelte më në këtë dhomë sa të ndodhesha unë, ose të bëja të kundërtën. Mirëpo në rrethanën e dhënë, kur me këtë botë s'më lidhte më asgjë përveç planit hakmarrës, ajo ishte qenia e vetme e afërt për mua. E vështrova në sy me ngulm, si të doja të bindja veten nëse mund t'ia besoja të fshehtat e mia. Ajo u skuq, duket u turbullua ose e keqkuptoi vështrimin tim dhe u ngrit, doli nga dhoma.

Vendimin për t'iu hapur Dizit e përshpejtoi një rrethanë e papritur. Afër mbrëmjes u ndjeva i kthjellët dhe për herë të parë u ngrita nga shtrati. Këputja trupore nuk më pengoi të endesha nëpër dhomë, të vështroja i hutuar pikturat në mure, pastaj të guxoja më tej, të

hidhja krahëve, mbi pizhame, pallton e madhe e të dilja në ballkon. Ajri i ftohtë i marsit më bëri të mbështillesha. Një keqardhje m'u derdh në shpirt për një tufë harabelash, të cilët e braktisën parmakun e ballkonit me frushullimë sapo dola unë. Më erdhi për të qarë ose nga harabelat e trembur, ose për shkak të qetësisë, të atij qielli pas një dite të tërë me shi, ku ndonjë yll sapo kishte zënë të fekste, në kufirin midis ditës dhe natës, kur ende nuk është as ditë as natë e në një çast të tillë shpirti vetvetiu të dhemb. Tek rrija i mbështetur pas murit mendova se nuk isha i denjë për atë çast mrekullimi: Linda nuk ishte pranë meje. Këtë deshi të ma nguliste në kokë edhe kënga e incizuar e hoxhës që u çlirua prej minares së xhamisë aty rrotull, e dridhshme dhe enigmatike, me një mesazh të pazbërthyeshem për veshët e mi.

Sapo mbaroi thirrja, në rrugën para vilës, sytë më zunë tre djem të rinj. Ata qëndruan në cepin e pallatit përballë. Bisedonin me zë të ulët, por edhe po ta ngrinin zërin unë nuk do të mund të dëgjoja gjë, megjithëse përreth ishte një qetësi ndjellakeqe, s'dukej këmbë njeriu, çka më dha të kuptoja se kishte mbërritur çasti i hyrjes në fuqi të ndalim-qarkullimit. Më në fund ata lëvizën nga qoshja e pallatit. Tashmë ishte bërë errësirë, aq sa unë shquaja vetëm hijet e tyre. Më tutje nuk mora vesh çfarë ndodhi. Ndjeva dy krisma

revolveri, pashë trupin e njërit prej djemve të përmysej mbi një pellg me ujë dhe dy të tjerët që ia dhanë vrapit e u zhdukën. Unë vazhdova të qëndroja në ballkon, i mbështetur pas murit. Trupi i të vrarit në pellgun me ujë ndriçohej zbehtë nga refleksi i dritave të ndezura në apartamentet e pallatit aty pranë. Nuk mund të them sa vazhdoi ajo shurdhëri, sa kohë qëndroi vetëm i vrari me trupin në ujë dhe kokën e larë me gjak këndeje ujit.

Absurde ta mendoje, por m'u duk sikur vrasësi isha unë. Kaloi një kohë e gjatë, ndoshta një shekull, derisa prej diku doli një njeri e ky zuri t'i afrohej kufomës. Lëvizjet e tij ishin të druajtura, trembej se mos kufoma kërcente përpjetë, e mbërthente për fyti. Sigurisht, kufoma nuk kishte ndër mend të kërcente përpjetë. Ajo rrinte pa lëvizur, me trupin në ujë dhe kokën e larë me gjak këndeje ujit, pa u bërë merak se ndërkaq rreth pellgut kureshtarët po shtoheshin, madje njëri prej tyre ia ndriçoi fytyrën me petromaks. Një shekull më pas u dëgjua një sirenë alarmi, në fillim e largët, pastaj gjithnjë e më afër, çka dëshmonte se dikush aty rrotull duhej të kishte lajmëruar me telefon policinë ose ambulancën e urgjencave. Ishte një veturë policie. E pashë të arsyeshme të mos e ndiqja më spektaklin, u ktheva brenda.

Pa e hapur dritën zura të vërtitesha nga një cep i dhomës në tjetrin. Në thellësi të kafkës më

shkreptiu një blic. Diçka në trajtën e një qenieje të mjegullt u shfaq në një pjesëz të sekondës, pastaj po aq vetëtimshëm u zhduk bashkë me ndriçimin e blicit. Mbeta përsëri në errësirë dhe i pështjelluar mbërrita anën e krevatit. U ula, nuk arrija t'i shpëtoja ndjesisë absurde se vrasësi i atij njeriu pak më parë kisha qenë unë.

Kështu më gjeti Dizi, ulur në cep të krevatit, me kokën midis duarve. Kur ajo hyri në dhomë pa guxuar as të fliste, as të ndizte dritën, isha i përpirë nga një shfaqje halucinante në ekranin e trurit, si një sekuencë filmike. Ndieja një krismë, dikush shembej në një pellg, pastaj sekuenca kthehej mbrapsht, stërkalat e ujit mblidheshin, gjaku bashkë me copëra të shpërndara trush përthitheshin nga një zgavër e hapur në kokë, trupi i shkëputej tokës, vinte në pozicionin fillestar kur një tytë revolveri mbështetej në tëmthin e tij e më dukej se dora që mbante revolverin ishte e imja.

I llahtarisur i rashë në të se ndodhesha në dhomë, ulur në cep të krevatit, me kokën shtrënguar midis duarve dhe Dizi, pasi kishte hapur dritën, po më lutej të shtrihesha në krevat. Iu binda, mendova se veprimi më i arsyeshëm nga ana ime do të ishte të shtrihesha në krevat. Atëherë Dizi zuri të më shpjegonte, gjithnjë me zë të ulët, gati si pëshpërimë, tmerrin që i ngjallte kjo dëshirë e pangopur e njerëzve për të larë hesapet.

– Mjerë kush ka hesape, – tha, – por nëse duan të vriten, le të vriten, ndryshe shpirtrat e tyre s’do të gjejnë qetësi as në varr.

Në rrethana të tjera kjo temë do të më tërhiqte. Një diskutim me Dizin për qetësinë e varrit ndoshta do të kishte qenë me vend edhe për atë, edhe për mua. Mirëpo mua më mundonte një problem konkret, pa sqarimin e tij, siç kishte thënë ajo, nuk do të ndihesha i qetë as në varr. Plani im ishte tjetër, ishte pjekur brenda meje në fshehtësi, një plan i rrezikshëm, plot pikëpyetje, përderisa duke pranuar një krim do të mbetesha i zbuluar, i hapur ndaj dyshimeve, akuzave dhe shpifjeve rreth gjendjes sime, por një perspektivë e tillë nuk më shqetësonte.

Për të qenë i sigurt ndërmora një manovër, e vura Dizin të betohej. E detyrova të shkonte të gjente librin e Kuranit, im atë e mbante në shtëpi pa qenë besimtar. Dizi aq më pak ishte besimtar. Kjo nuk më pengoi ta vija të betohej me dorën mbi Kuran e ajo pranoi pa e zgjatur, përsëriti fjalë për fjalë formulën që i diktova unë, pra nuk do të më tradhtonte, zotohej solemnisht para Zotit e para meje, në të kundërt le të binin mbi të rrufetë e qiellit.

Dizit iu drodhën buzët, zëri iu mek. Atëherë unë i rashë shkurt, i pohova krimin. Pak a shumë në mënyrën me të cilën disa çaste më parë dy të panjohur kishin vrarë një person e ky vazhdonte të ndodhej me trupin në pellgun

me ujë dhe kokën e larë me gjak këndej ujit. I kërkoja Dizit ta mbante të fshehtë këtë pohim, mbi të gjitha të mos ia tregonte tim eti.

Asaj i shpëtoi nga dora libri i Kuranit dhe u përkul ta merrte. Duke përfituar nga hutimi i saj i shqita një premtim të dytë: të nesërmen të shkonte sa më shpejt në bar-kafe “Pacifik”. Atje të takonte një banakier me emrin Joni. T’i thoshte atij të vinte të më takonte për një çështje me shumë rëndësi. Fjalët e fundit i shqiptova në mënyrë disi të veçantë dhe Dizi, në mirëkuptim, tundi kokën. Qe shastisur, por unë nuk i dhashë rëndësi shastisjes së saj, as mënyrës disi të çuditshme sesi më vështronte. Truri im ishte ndezur, ishte vënë në lëvizje, synimi im i vetëm mbetej zbulimi i krimit. E përmes shpalljes publike të tij të shkoja më tej, larg, aq larg sa truri i Dizit, i tim eti, i të gjithë atyre që më rrethonin, truri i zyrtarëve shtetërorë e politikë, nuk mund të shkonte dot.

Tërë atë natë nuk vura gjumë në sy. Isha bërë i tejndjeshëm, dëgjoja dhe zhurmat më të vogla. Atë natë krismat e armëve qenë më të egra dhe përkundër porosisë së Dizit, sipas së cilës mund të haje ndonjë plumb qorr, dola në ballkon. Vështroja shiritat e zjarrtë të plumbave gjurmëlënës në ekstazën e një hareje të çmendur, një ngazëllim i lig më ngrinte

peshë. Vinte një çast e si me komandë armët heshtnin. Por kjo zgjaste pak. Diku, në cep të qiellit, shfaqej një shatërvan. Në veshët e mi mbërrinte zhurma e krismave, atyre u përgjigjeshin valë të tjera, pasonte gjëmimi i ndonjë granate, xhamat dridheshin, hapësira lëkundej, edhe qielli. Vetëm bluja e tij e errët mbetej e palëvizshme, indiferente ndaj gërricjeve të ca qenieve të dhjera, të cilat gjenin natën për të dalë nga vrimat, harboheshin, shanin, klithnin, më në fund mërziteshin, lodheshin, po ndoshta e kuptonin kotësinë e marrëzisë së tyre, s'u mbetej më vrer për të vjellë dhe ktheheshin nëpër skuta të mpirë, në pritje të një mbrëmjeje tjetër, kur pas një dite të mbushur me ankth ekzistencial, shpirtrat ngarkoheshin përsëri me vrer dhe çliroheshin duke pështyrë qiellin.

E nesërmja gdhiu me shi. Ende pa u ngritur nga shtrati, pashë tej dritares një fragment gri. Qielli, mendova, ka të drejtë t'ua kthejë qenieve të dhjera pështymat me pështymë. Por ai është i dhembshur, u dërgon shi, domethënë ujë. Dhe uji, ndoshta, përveç fëlliqësive të trupit, mund të lajë edhe mëkatet e shpirtrave të tyre. Ndërsa mua të më shuajë zjarrminë e trurit... Pas një nate pothuajse pa gjumë isha i paduruar të flisja me Dizin, të sigurohesha se ajo do të nisej për në bar-kafe "Pacifik". Mirëpo Dizi po vonohej ca si tepër që të ngjitej tek unë, siç bënte çdo ditë, kur hynte në dhomë e

bashkë me përshëndetjen e ditës së re, më sillte, mbi një tabaka, mëngjesin.

Truri im i nxehtë dhe vonesa e Dizit u bënë shkak të dilja në ballkon. Me pallton e madhe krahëve, ia ktheva fytyrën qiellit. Tek ndieja pikat e ftohta mbi ballë, më përshkoi një dridhmë: dy policë të mbështjellë me mushama të zeza po rrinin pranë hyrjes së pallatit matanë rrugës. Doemos, atje mund të rrinin dy, katër, katërmbëdhjetë policë dhe unë s'kisha arsye për t'u shqetësuar. Mirëpo vështrimi i tyre këndej, nga ballkoni ku unë mbeta si i ngrirë nën pikat e shiut, nuk mund të më linte indiferent. Një polic i zakonshëm, dua të them pa synime djallëzore në kokë, ndjek rrugën e vet, nuk zë strehët e pallateve, aq më pak nuk kuturiset ta shfaqë haptazi praninë e tij të dyshimtë, në vende e çaste të dyshimta, siç po vepronin tani dy policët me mushama të zeza matanë rrugës. Sado të përpiqeshin, ata s'mund t'i shpëtonin vrojtimit tim, sytë nuk më gabonin, po shihnin këndej nga unë, me interes të dukshëm, diçka i thoshin njëri-tjetrit ultazi e unë nuk mund të mos dyshoja se po flisnin pikërisht për mua.

Nuk lëviza nga vendi, çdo veprim i pakontrolluar imi mund të kthehej kundër meje, sidomos pas vrasjes së mbrëmshme ca më tutje, pranë pellgut me ujë. Vazhdova të rrija me fytyrën nga qielli dhe nuk u tunda prej andej edhe pse shiu u bë më i dendur, edhe pse,

ndërkaq, policët as e merrnin mundimin të ruheshin prej meje, ata e mbanin vështrimin nga unë, haptazi, bisedonin, gjallërisht, të thuash se ja, gjithçka ishte e qartë, autori i vrasjes së mbrëmshme ndodhej aty, përpara tyre. Sigurisht, gabonin trashë. Pas një shqetësimi fillestar, pjellë e befasisë, kjo më dha qetësinë e duhur, madje kënaqësinë t'i vija në lojë, domethënë t'ua tërhiqja vëmendjen me shkujdesjen time. Le të mendonin se unë isha vrasësi, e vërteta qëndronte një mijë kilometra larg. Unë nuk isha autori i vrasjes së mbrëmshme, këtë s'mund ta vërtetonin jo ata dy teveqelë, por edhe sikur të mblidheshin një mijë ekzemplarë të tjerë të sojit të tyre.

Paniku më përfshiu pak më vonë. Në fillim, i përpirë nga loja me policët, ndjeva një sirenë të largët. Edhe ata e ndjenë sepse kthyen kokat nga kreu i rrugës, ku i çova sytë dhe unë. Atëherë, përmes shiut, që tashmë binte me gjyma, shquajta turirin e një autoambulance. Ajo u derdh me vrull për këndeje, sirena e alarmit lehte llahtarshëm. Vështrimi im u përplas me atë të policëve, ata u ngërdheshën, shqiptuan emrin tim e kësaj radhe u ngjetha. Përjetova diçka të njohur, një ankth e frikë të harruar. S'pata më asnjë dyshim, policët ndodheshin aty për mua, autoambulanca vinte për mua, kishin ardhur të më merrnin, të më çonin s'di se ku.

E braktisa ballkonin dhe u ktheva në dhomë. Një copë herë u përpoqa të mblidhja veten, t'u jepja gjërave një shpjegim, të arsyetoja, por kjo qe e pamundur. Së fundi ndjeva hapa nëpër shkallë, rashë pre e panikut. Flaka pallton tutje, u futa në krevat, u mbulova kokë e këmbë me jorgan, trupi më dridhej, koka më buçiste, zemra po më çante kraharorin.

“Më kanë spiunuar, mendova, më kanë spiunuar. Mua më kanë spiunuar!”

3

“Na kanë spiunuar, fëlliqësirat... komshinjtë, s’ka kush tjetër. Dhe tani do të vijnë ta marrin...”

Kështu tha babai, e dëgjova qartë. Ata po rrinin të dy, bashkë me nënën, pranë dritares, duke vështruar fshehurazi përmes perdes, poshtë, rrugën para pallatit. Babai lakoi me egërsi fjalën spiun, në njëjës e në shumës, përdori epitete të rënda. Unë e kisha dëgjuar rrallë të përdorte sharje aq të rënda e kjo më dha të kuptoja shkallën e zemërimit të tij.

“Edhe mua më kanë spiunuar, thashë me vete, dhe tani po vijnë të më marrin...”

Shtrëngova tëmthat. Një ngatërresë e tmerrshme po ndodhte brenda meje. Prej një jave më mbanin mbyllur në shtëpi, rrija në

shtrat, s'kisha të drejtë të kapërceja as prapun e dhomës, të vetmit njerëz që futeshin tek unë ishin prindërit. Me ç'më shpjegoi nëna, vuaja nga një sëmundje me emrin popullor Verdhëz, hepatit viral, në gjuhën shkencore. Nëna më tha se ajo ishte një sëmundje e keqe, prandaj duhet të rrija mbyllur e, siç mësova më pas, në fshehtësi të plotë. Sëmundja qenkej jo vetëm e keqe, ishte dhe mjaft ngjitëse, pra e rrezikshme, përveç ndonjë njeriu shumë të afërt të familjes askush nuk duhej ta merrte vesh, sidomos komshinjtë. Ndryshe, po të merrej vesh e fjala të shkante atje ku s'duhej, domethënë te ndonjë veprimtar i lagjes, prindërit e mi do të gjobiteshin për shkelje të ligjeve, mua do të më rrëmbenin në çast, do të më çonin në spitalin infektiv, në izolim të plotë e atje kushedi ç'tortura të reja më prisnin.

Jashtë vazhdonte të binte shi. Unë duhej të dilja sa më pak në ballkon, t'i ruhsha ndonjë të ftohure, organizmi im tepër i dobësuar mund të binte lehtë pre e ndonjë sëmundjeje të rrezikshme. Kështu tha nëna.

– Ti sapo ke kaluar verdhëzën, – vërejti ajo, – ta ngjiti Linda, megjithëse prindërit e saj na kundërshtuan, ata ishin të zemëruar, më shumë se të zemëruar të egërsuar. Sipas tyre e vërteta qe ndryshe, Lindës ia kishe ngjitur verdhëzën ti dhe tash e tutje do ta ndalojnë të rrijë me ty.

Pohimet e nënës më tronditën me lajthitjet e padyshimta dhe lajthitja e parë lidhej me Lindën. Shihej qartë, në mendjen e saj ndodhte një përzierje kohësh dhe emrash. Sepse kur unë njoha Lindën, nëna nuk ishte më. Ajo ngatërronte Lindën me Orianën, çka m'u duk e natyrshme. Edhe unë kur njoha Lindën pata përshtypjen se rigjeta Orianën, aq e madhe ishte ngjashmëria midis tyre e ndoshta kjo më bëri të mos i jepja rëndësi lajthitjes së nënës.

Më tej s'mora vesh çfarë ndodhi dhe, si në filmat vizatimorë ku figurat pështjellohen, prindërit m'u fshinë nga pamja. Babai nuk ishte më pranë dritares duke vështruar përmes perdes e duke sharë. As nëna. Në vend të tyre ndodhej një fëmijë. Ai rrinte me duar të kryqëzuara para kraharorit, pak i kërrusur, fytyrën e kishte të zbehtë dhe dridhej si t'i kishte hyrë i ftohti në palcë.

– Mos më shih ashtu, – tha gjithnjë duke u dridhur. – Të dy ne kemi ngecur në një merimangë virtuale, si në atë lodrën e dikurshme të fjalëve. E mban mend? Ti je unë, unë jam ti, kush e pi shurrën, unë apo ti...

Ja qepa sytë me dyshim, i ngacmuar diku thellë, i pazoti të zbërtheja ç'kërkonte të thoshte ai me shprehjen “ti je unë, unë jam ti”, sidomos me atë pyetjen përmbyllëse. Kishte diçka familjare për mua në llomotitjet e atij mistreci, në zbehtësinë e asaj fytyre edhe të druajtur,

edhe të frikur. Ai u shkëput nga dritarja dhe vajti u ul në një kolltuk në qoshe të dhomës ku ishte ndezur një reflektor i madh, e ai zgjati duart për t'u ngrohur.

– Së paku më dëgjo, – zuri të fliste duke vazhduar të dridhej. – Por më parë harroje atë lodrën e fjalëve, nuk ka dyshim se unë jam ti, ti je unë e, sa i përket vazhdimit, atë gjënë e kam pirë unë, jo ti. Megjithëse unë jam ti, ti je unë, domethënë se po e pata pirë unë...

– O Zot, – mërmërita, – po më çmend!

Desha të kërceja nga krevati, ta zija për veshi, t'i jepja një shuplakë. Por ai, si të ma kishte lexuar mendimin, u zgërdhi.

– S'mund të më keqtrajtos, – tha, – do të ishte e padrejtë. I kam unë të gjitha arsyet të të mbaj mëri!... Ti nuk e di sesa e tmerrshme është për mua të mësohem me idenë se do të mbetem përjetësisht këtu ku jam, pa asnjë mundësi shpëtimi. Endem i shastisur brenda mureve të një muzeu të frikshëm dhe e di mirë se s'do të mund të dal dot kurrë prej këndej. Për këtë ka një fajtor. Ky, sigurisht, je ti. Kur isha unë, ti nuk ishe, kur erdhe ti, më përzure. Ndonëse unë jam ti, ti je unë dhe nuk ka rëndësi se kush e pi atë gjënë. Kemi pirë edhe më të hidhura, me ndryshimin se unë nuk mund të pi më asgjë, ndërsa ti vazhdon avazin e vjetër, të gëlltisësh po atë hidhësi të pështirë, e je katandisur për të zënë kokën me

duar, e më sheh sikur unë të mos kem ekzistuar ndonjëherë dhe s'ke të bësh fare me mua, në këtë muze ku jam mbyllur me fantazma të dikurshme.

O Zot, mëmërita përsëri, në prag të shterimit nervor, pa mundur as të reagoja, as t'i shpëtoja pushtetit të tij. Derisa më në fund pata një kthjellim dhe kuptova diçka që më shtangu: gjendesha përballë vetvetes!

U ngrita ndenjtur në krevat. Për një çast edhe zhurma ngjethëse e sirenës së autoambulancës, edhe frika e një bastisjeje nga policia, u fashitën. Tjetri matanë e nuhati. Një buzëqeshje e trishtuar iu end në fytyrë, tundi dorën me një lëvizje të lodhur dhe e çoi vështrimin nga dritarja.

– Mos ki frikë, – tha, – jam fëmijëria jote... Kuptohet, në pikëpamje fizike i përkas në mos një bote të vdekur, një bote të kaluar. Mirëpo njerëzit shpesh tregohen naivë kur mendojnë se ajo që kaloi nuk është më. Iluzion, gënjeshtër, së cilës njerëzit kanë dëshirë t'i besojnë. Megjithatë t'i lemë filozofitë. Mua më vjen keq për ty e kjo, sidoqoftë, është keqardhje për veten. Unë jam ti, ti je unë, pra, nëse ti ndihesh viktimë, po aq viktimë ndihem dhe unë. Tani ty të ka hipur në kokë të gjesh xhelatin. Bravo! Po a e di ti se cili është xhelati?

Në fillim duhet të shtiesh në kokë se autoambulanca poshtë pallatit dhe policët në trotuar nuk janë për ty. Ata janë për mua.

Këtu nis historia, nëse mund të quhet histori ajo që do të rrëfej. Po e nis nga fundi, s'kam ç'bëj, dhe fundi është sëmundja e mallkuar, e cila i jep fytyrës së njeriut ngjyrën e vdekjes. Pati mjaft thashetheme, për të mos thënë gomarllëqe. Marrëzia kulmoi me grindjen midis babait dhe prindërve të Orianës, pra ia kisha ngjitur unë Orianës verdhëzën apo e kundërta, ma kishte ngjitur ajo mua. Ndërsa ne u sëmurëm të dy njëkohësisht për një arsye të thjeshtë. Një natë, padashur, shkelëm hijen e një xhindi pranë rrënojave të asaj teqesë së shkatërruar, e vetmja mbeturinë nga lagjja e vjetër pranë varrezave të Bamit, ku gjendej shtëpia jonë, më saktë pallati ku banonim ne. Kjo do të thotë se as unë nuk ia kisha ngjitur verdhëzën Orianës, as Oriana mua, megjithëse u përfolëm shumë, prindërit na ndaluan të rrinim bashkë, na ndanë në klasa të ndryshme, më pas Oriana u detyrua t'i vazhdonte mësimet në një shkollë tjetër, derisa një ditë familja e saj u mbart, e ne nuk u pamë më. Tani, i mbyllur në muzeun me fantazma të dikurshme, unë e kërkoj Orianën më kot. Netëve shkoj te rrënojat e Teqesë me shpresë se ajo do të vijë, më së fundi do të shihemi prapë e do të kujdesemi të mos shkelim më në hije xhindesh. Por Oriana nuk vjen. Dhe unë mbetem vetëm, me peshën e një të fshehte që nuk ia zbuluam kurrkujt: atë natë fatale të shkeljes së xhindit, unë dhe Oriana vendosëm të fejojeshim...

Mos qesh, po them të vërtetën. Atë natë me hënë, pranë rrënojave të Teqesë unë dhe Oriana u fejuam në një ceremoni pa dëshmitarë, përveç yjeve në qiell dhe shpirtrave të këqij.. Këta dalin në formë lugetërish dhe mjerë kush shkel hijen e tyre, do ta pësojë në vend, siç e pësuam unë dhe Oriana që u sëmurëm nga verdhëza e unë kalova lloj-lloj torturash. Por kjo është një histori e gjatë, ti s'ke përse shqetësohesh, autoambulanca dhe policia nuk janë për ty. Ti nuk vuan nga verdhëza, nga verdhëza vuaj unë, vuan dhe Oriana dhe ata kanë ardhur të na marrin të dyve. E mua më duhet të fshihem, t'i ruhem dhe babait, përndryshe ai do të më detyrojë të pi një filxhan plot me antikorpe, thënë shqip, me shurrën time... Nuk mund ta marrësh me mend se çfarë torture është të gëlltisësh një filxhan të tillë... Çështja është si t'u shpëtoj antikorpeve... Më kot e pres Orianën te rrënojat e Teqesë, nën dritën e hënës, si atë natë kur e putha në faqe e ajo më puthi në buzë, e unë vazhdoj të dridhem me fjalët që më zihen në grykë. Sapo nis të rrëfej nga fundi historinë e një nate me hënë, gjithçka më bëhet lëmsh, koka më buçet nga zhurmat, një stuhi zhurmash si frymë lugetërish.

I dëgjon? Ja tek janë, po vijnë të më marrin, ata, të përhershmit, mjekët dhe policia... Do të më çojnë prapë në spitalin me fantazma. Po vijnë... Po vijnë...

Në kuadratin e derës nuk u shfaqën as uniforma të bardha, as policë. U shfaq fytyra e Dizit. Pas saj im atë. Pas tij fytyra të tjera.

Po rrija me bërryl të mbështetur mbi jastëk dhe ardhja e tyre më zuri në befasi, nuk mund të simuloja, dua të them s'mund të shtiresha sikur po flija. Ndërkaq mërdhaci pranë reflektorit të ndezur në qoshe të dhomës ishte zhdukur.

Nuk kisha kurrfarë dëshire të duroja praninë e kaq shumë njerëzve. Ata më kishin prishur vrazhdësisht një orvatje për të rigjetur kujtesën e shkërmoqur. Plani im do të mbetej në mes të rrugës sikur copëzat e humbura të kujtesës sime të endeshin kuturu nëpër hapësirë. Duhej të bëja çmos t'i mblidhja, t'i

vendosja pranë njëra-tjetrës, si fragmentet e një mozaiku të shkatërruar nga një tërmet. Kisha ndjesinë se edhe unë vetë isha një mozaik i varrosur nën shtresa të trasha. Këtë desha t'ua them të porsaardhurve, mbanin apo nuk mbanin bluza të bardha ose uniforma policësh, jam një mozaik i mbytur, më lini të qetë. Në vend të kësaj zgjodha shpërfilljen. Dhe heshtjen ndaj çdo pyetjeje të mundshme.

Fillimisht nuk m'u drejtua ndonjë pyetje. Njerëzit mbetën në hyrje të dhomës, fytyrat e tyre shpallnin turbullim, një seriozitet solemn i kthente në maska të hutuara. Sytë e mi u kryqëzuan me ata të tim eti dhe ndonëse qe vetëm një çast, më mjaftoi të hetoja sërish heqjen e tipareve të tij, një kërrusje të trupit. Në rrethana të tjera, diçka e tillë do më bënte të më vinte keq, sinqerisht, të vrisja mendjen të gjeja ç'brengë e mundonte shpirtin e atij njeriu të fortë. Sepse im atë kishte qenë gjithmonë njeri i fortë. I ishte dashur të sillej kurdoherë i fortë.

Nuk qëllova tipi i tij. S'kam qenë kurrë i fortë në kuptimin që im atë i jepte kësaj fjale. Tërë jetën ai bëri çmos të më modelonte sipas parametrave të tij, të pëlqejta ç'i pëlqente atij, të urrejta gjithçka urrente ai, ky ishte një rregull të cilit nuk duhej t'i shmangesha, siç nuk i qe shmangur ai, siç nuk do t'i shmangej derisa të qe gjallë. Por unë kam qenë zhgënjimi i madh i tim eti, nuk u bëra i fortë. Këtu qëndronte paradoksi. Në ato çaste nuk ndieja keqardhje

tek e gjeja me trup të kërrusur e tipare të përthithura, kur para meje shihja një njeri krejt të ndryshëm nga i vërteti. Rolet ishin përmbysur. Në atë çast të kryqëzimit të syve tanë kuptova se ai nuk ishte më njeriu i fortë. I forti, për paradoks, isha unë.

Ai ma lexoi mendimin, qëndroi në hyrje të dhomës, pa guxuar të afrohej drejt meje. Guxoi Dizi. Ajo nuk dinte t'i lexonte mendimet e pathëna të të tjerëve, ndryshe nuk do të ngutej të më afrohej në një çast kur unë, i përfshirë nga një tërbim i heshtur, po mendoja se ajo kishte mëkatuar. E dëshmonte prania e pakuptimtë në dhomën time e aq shumë njerëzve. Ata ndodheshin për mua, merrej me mend. Fytyrat e tyre shfaqnin një shqetësim grotesk dhe ia ngula sytë Dizit në një përpjekje për të sqaruar domethënien e asaj maskarade.

“Për besë, thashë me vete pothuajse i sigurt, mbrëmë, kur i është futur në shtrat tim eti, ajo më ka tradhtuar”.

Ideja se e fshehta ime tashmë mund të mos ishte një e fshehtë, më erri. Mezi ia dola të ndrydhja brenda vetes një dëshirë për t'i shporrur të gjithë të pranishmit, t'u thosha se unë nuk isha ndonjë majmun i kopshtit zoologjik, as kavie eksperimentale. Dizi, duket, e nuhati këtë. M'u afrua maturisht, me një buzëqeshje të shpifur. Të pranishmit ndodheshin aty për pak minuta, sa të më ndërronin fashat, të më shihnin kokën dhe të merrnin mbajtësin

metalik të serumit. Gjendja ime ishte përmirësuar, unë s'kisha më nevojë për serum, kështu vërejti ajo, gjithnjë e matur, me një zë që kërkonte mirëkuptim.

– Ti më ke tradhtuar, – i thashë kur të panjohurit, për të cilët dyshova se gjysma ishin mjekë e gjysma tjetër policë të veshur civilë, u larguan bashkë me tim atë.

Dizi kishte hapur derën e ballkonit për ajrosjen e dhomës. U dëgjua sirena e një makine dhe mendova se ishte autoambulanca, e unë vazhdoja për çudi të ndodhesha në shtrat, pra nuk më kishin marrë, nuk e kuptoja përse, dhe i përsërita Dizit akuzën time për tradhti.

Ajo më këshilloi të mbulohesha, jashtë binte shi e frynte erë... Ndërsa unë kisha arsye të këmbëngulja në tradhtinë e saj. Pyetjet me nëntekste të dyshimta që më kishin drejtuar dy nga vizitorët, kur një vajzë veshur me xhinse po më ndërronte fashat e kokës, formonin provën për natyrën e qëndrimit plot dykuptimësi të njerëzve rreth meje. Hetuesit e mi deshën të mësonin, për shembull, cili ishte personi ose fytyra e fundit që mbaja mend, çfarë ndieja në kuptimin fizik të fjalës, si e shpjegoja praninë time në atë lagje periferike të Tiranës, ku kalimtarë të rastit më kishin gjetur pa ndjenja në një hendek buzë rrugës. Vargu i pyetjeve do të vazhdonte gjatë sikur

unë, i alarmuar nga nëntekstet e lexueshme, të mos merrja masa mbrojtëse dhe masa më e mirë ishte injorimi i tyre me heshtje.

Kur ia përsërita akuzën për të dytën herë, Dizi u zbeh. Ndoshta nga frika. Unë s'desha t'i fusja ndonjë frikë. Desha vetëm t'i vija në dukje neverinë që më ngjallnin veprime të tilla poshtëruese. Kështu i thashë, ke vepruar poshtërsisht duke shpërdoruar besimin tim e tani më duhet të përballoj debilët që im atë m'i sjell në dhomë për të testuar gjendjen time, të vërtetojë se mbase unë kam shkalluar e do të ishte më mirë të më mbyllnin në ndonjë çmendinë, fjala vjen në Vlorë. Dhe shtova:

– Kam dëgjuar se në Vlorë gjendet një çmendinë nga më të specializuarat, po të të mbyllin atje, thuhet, s'del dot më përveçse me arkivol, por mua aq më bën, më mbyllin në Vlorë apo gjetiu, njësoj është kudo në Shqipëri, një azil të çmendurish ku nuk e merr vesh i pari të dytin, e këta im atë m'i sjell të testojnë gjendjen time sepse ti nuk e mbajte fjalën. Mos u mundo ta mohosh, do të jetë më keq për ty. Mëkati i përsëritur është më i rëndë, dënimi gjithashtu... Tani më shpjego, përse asnjë nga miqtë e mi s'është bërë i gjallë të vijë të më shohë? Kjo ka vetëm një shpjegim: dikujt i intereson të më mbajë mbyllur, dikush do që unë të mos jem në gjendje të vë në zbatim planin e hakmarrjes. Në këtë komplot bën pjesë edhe ti...

Dizi qëndroi e zbehur në mes të dhomës pa vendosur dot në duhej të më kundërshtonte apo thjesht të largohej nga dhoma. Pavendosmëria e saj e shastisur më përftoi një kënaqësi të ligë. Kështu është ndier Hamleti pas vrasjes së Pollonit, mendova dhe kërceva në këmbë i habitur dhe vetë nga kjo përqsasje. Një uturimë e thellë më zhurmoi në kokë. E zura Dizin për dore dhe e mbështeta pas murit. Zhurma në thellësi vinte valë-valë, si një uragan i ndrydhur në kapakun e rëndë të një kazani. Dizi shqeu sytë, buzët iu hapën, mezi po mbushej me frymë. Ajo nuk i dëgjon zhurmat, mendova, dhe nuk është nëna ime. Është shumë e re për të qenë nëna ime... Unë mund ta filloj hakmarrjen tani, në këtë çast, duke ia rrëmbyer për fare tim eti këtë grua me fytyrë të bukur. S'do të kishte asgjë të jashtëzakonshme, do të ishte në përputhje me moralin e kohës, kur vriten njerëz çdo ditë dhe në kanalet televizive ngadhënjën seriali Beautiful.

– Mendo, – e vazhdova arsyetimin duke i folur me zë, – përfytyro çfarë skandali! Megjithëse si dramë do të ishte mizerabël, me personazhe të vogla edhe më mizerabël. Nëna ime ka vdekur, ti s'je nëna ime. Dhe unë s'kam vrarë gabimisht ndonjë Pollon në vend të tim ungj. Im ungj gjithashtu ka vdekur, vite të shkuara, në burg. Im ungj nuk u orvat t'ia rrëmbente tim eti të shoqen, as ta vriste, as t'i

merrte fronin, ndonëse im atë, me gjithë prepotencën e tij imperiale, nuk ka qenë ndonjëherë mbret. Ai ndihet mbret tani dhe mbretëresha je ti. Siç e sheh gjithçka është banale, një farsë e shpëlarë, e unë më kot synoj të gjej kënaqësinë hakmarrëse të Hamletit. Tani shko thuaji tim eti se unë të kam përdhunuar... Ti e di mirë, kjo nuk është e vërtetë. Por ti ke të drejtë ta sajosh historinë tonë si të duash. Mbase do të kemi një dramë...

Atë çast zhurma e uraganit u fashit. Trurin ma përshkoi një trullosje dhe në veshë më kumboi një zë i butë. Ishte Linda. Lëre atë, më pëshpëriti. Është më e pafajshmja. Pastaj zëri u largua nëpër derën e hapur të ballkonit prej nga futej ajri i lagësht. U drodha kur vura re se isha vetëm. Nuk e kuptova sesi qe shkëputur Dizi prej meje, duke më lënë një ndjesi mishi të nxehtë, aromën e parfumit dhe llahtarit që ishte shfaqur në sytë e saj.

Të nesërmen pata vizitën e parë. Nuk ishte Joni, kolegu im i bar-kafesë “Pacifik”, siç shpresoja, as ndonjë nga të njohurit e përhershëm të klubit. Unë e prisja që dikush, i ndryshëm nga të padëshiruarit, një shumësi specimesh me kureshtje provokative, të vinte të më shihte. Ndërsa atë nuk e prisja. Mua thjesht nuk më shkonte nëpër mend një vizitë prej saj. Dhe, kur erdhi, mezi u kujtova cila qe.

Sytë e mi u ngulën së pari në fytyrën e Dizit,

pastaj, të përzënë nga një shpërfillje e ftohtë, zbritën tek e porsaardhura. Ajo sajoi një buzëqeshje. Bashkë me buzëqeshjen iu var një pikë loti. Dizi e pa të arsyeshme të na linte vetëm. Kjo ndodhi në çastin kur unë, i zgjuar nga pika e lotit e vizitores në të zeza, u kujtova cila ishte.

– Jam Silva, – tha ajo, – motra e Spartit.

Shikimi im u end pavetëdijshtëm nëpër muret e dhomës ku vareshin piktura. Të gjitha dhurata të miqve të mi. Nga ato që pas grindjes me tim atë mbetën atje, në dhomën time te shtëpia e vjetër e tani, pothuaj në të njëjtën vendosje, gjendeshin këtu. Shumica ishin punime të Lindës. Sparti më kishte dhuruar dy pëlhura. Kur u prisha me tim atë, s'mund t'i lija pa i marrë me vete...

– I mora me vete, – mëmërita e kjo m'u duk mënyra më e përshtatshme për të nisur një bisedë me të porsaardhurën. – Ishin pëlhurat më të bukura të Spartit. Nuk ndodhen këtu, më vjen keq. Gjenden në vend të sigurt dhe shpresoj ta sjellë rasti t'i shohësh.

Ajo ishte ulur në karrigen ku zakonisht rrinte Dizi. Edhe në sytë e mi ndërkaq qe dukur ndonjë pikël për shkak të pikturave në mure, atyre që ishin dhe atyre që nuk ishin. Po ndoshta për shkak të zbehtësisë së fytyrës së Silvës. Kështu e kisha njohur gjithmonë, të zbehtë e të heshtur, me një brengë të ndrydhur, sikur fati e kishte paracaktuar të vuante

dhimbjen e të tjerëve. Siç vuante tani dhimbjen time.

E falënderova. Jo me fjalë. “Të jam mirënjohës, i thashë. Ti e dije që ne prisnim një vajzë. Të gjithë e dinin, madje dhe emrin e saj. Linda dëshironte ta quanim Monalizë, ndonëse askush në farefis, as ndonjë e njohur apo mikeshë, nuk quhej kështu. E quajtëm Monalizë kur mbushi muajin e shtatë apo të tetë në trupin e Lindës para se të vinte në jetë, ku erdhi jo me të qara si fëmijët e zakonshëm. Ajo erdhi pa lëshuar asnjë klithmë. Do të kishte qenë e drejtë të lëshonte së paku një klithmë proteste, para se ta fusnin në një arkivol të vockël, që prehet në dhé bashkë me arkivolin e Lindës. Së paku janë të dyja me njëra-tjetrën.”

Silva nuk reagoi dhe kjo qe e natyrshme. Kisha folur me vete. Ajo reagoi disi kur unë ndjeva nevojën t’ia përsërisja edhe një herë, kësaj radhe jo duke folur me vete. Silva mori dorën time dhe e mbajti midis duarve të saj. Në kontrast me pamjen e ftohtë të fytyrës, duart i kishte të ngrohta. Një rrymë e butë më depërtoi e bashkë me të një dëshirë për të folur. M’u duk se providenca më kishte sjellë të vetmin njeri tek i cili mund të mbështetesh pa frikë. Edhe unë, edhe ajo, përjetonim të njëjtën frymë të vdekur që hapte varre jo vetëm në varreza. Pastaj në dhomë u fut Dizi.

Më erdhi keq që Silva e lëshoi dorën time.

Dizi kishte sjellë një filxhan me kafe dhe Silva, si mërmëriti mbyturazi diçka, zuri të gjerbte në heshtje kafënë, e t'u përgjigjej pyetjeve të Dizit. Pyetje të kota për gjëra edhe më të kota. Derisa iu mbush mendja të largohej e na la përsëri vetëm. Por unë tashmë isha bosh. Sikur Dizi të mos e ndërpriste atë çast magjik të transmetimit të ngrohtësisë së Silvës nga trupi i saj në trupin tim përmes prekjes së duarve, unë, ndoshta, nuk do të flisja me vete. Do të flisja me Silvën. Dhe ajo do të më dëgjonte. Ndërsa unë, i kthyer në një masë të ngurtë, zura të flisja prapë me vete. Ajo nuk reagonte dhe kjo qe e natyrshme. Në fund, para se të largohej, më puthi në faqe e më la një copë pusullë.

E lexova kur ajo mbylli derën pas vetes. Pesë shifra të ruajtura brenda meje si një shkrim i lashtë mbi një gur varri. Atëherë u shkunda, mendova se duhej të bëja diçka, të çlirohesh nga ai prangim i trurit, i cili më kthente në një masë të ngurtë. Desha të besoja se po t'i formuloja diku ato pesë shifra, në anën tjetër do të më përgjigjej zëri i Spartit. Në mungesë të tij mund të dilte Silva, të më njoftonte se Sparti s'qe kthyer ende në shtëpi, siç ndodhte dendur, gjithnjë e më dendur, pa lënë kurrfarë adrese, e unë e dija përse zhdukej e s'isha në gjendje të bëja asgjë. Dhe befas kërceva nga shtrati. Në një çast kthjellimi truri im u çlirua nga ngërçi, u ndërgjegjësova se po humbja

çmendurisht një rast për të folur me Silvën. Dola në ballkon i elektrizuar, por ishte tepër vonë. Pashë Dizin te kangjella e oborrit dhe matanë, në rrugë, një veturë. Sapo ishte nisur dhe shumë shpejt humbi te kthesa e rrugës. Tek rrija duke u dridhur, sytë e mi u ndeshën me sytë e Dizit.

*S*ytë e mi u ndeshën me sytë e saj sapo u futa në sallën e madhe të restorantit në Hotel Tirana. Tryezën e tyre, larg hyrjes, në të djathtë, në një rast normal do të më duhej njëfarë kohe për ta gjetur. Por, atë mbrëmje lokali qe bosh. Dhe ndonëse im atë ishte ulur me shpinë nga hyrja, balerina Dizi, me pamjen e njohur prej vedete, ishte një shenjë ulëritëse.

I mbytur në djersë zura të shkoja drejt tyre duke u përpjekur të mblidhja veten. Im atë kishte plot arsye për të qenë i pakënaqur ndaj meje. Në shtëpi nuk isha dukur gjithë ditën, as në drekë, as më vonë, së paku sa të ndërrohesha, të vishja një bluzë të pastër e të mos paraqitesha kështu, me këmishën e ngjitur pas trupit. Pastaj ai mund të bënte

ndonjë skenë po të mësonte se ku kisha qenë e me ç'qëllim. Këtë nuk ia tregova as atë mbrëmje e as më vonë.

Tërë ditën Sparti qe përpjekur të më mbushte mendjen t'ia mbathnim. U takuam në mëngjes herët në një stacion autobusi të linjës së Kombinatit dhe kur mbërritëm te Kisha Katolike, përballë rrugës së ambasadave, gjetëm një turmë të madhe njerëzish. Prej shumë vitesh Kisha nuk ishte më kishë, ajo shërbente herë si teatër kukullash, herë për shfaqje amatorësh, por njerëzit e mbledhur aty s'donin të shihnin as kukulla, as amatorë. Një pjesë rrinin te shkallët duke pirë cigare, disa të shpërndarë andej-këndej nëpër hije, të tjerë në lokalin aty pranë duke pirë konjak. Me një shkujdesje të rreme, pa e ulur vigjilencën, sytë e të gjithëve shihnin në drejtim të rrugës së ambasadave. Atje gjithashtu që në mëngjes herët ishte rreshtuar një kordon i ngjeshur policësh të pajisur me kaska, mburoja të tejdukshme plastike dhe shkopinj gome.

Të dyja palët përgjonin dhe mallkonin njëri-tjetrin. Policët, të veshur rëndë, kullonin nga djersët nën diellin djegës të korrikut. Ata shtrëngoheshin pa entuziazëm, shumica ishin të gatshëm t'i flaknin edhe kaskat, edhe mburojat, edhe shkopinjtë prej gome dhe, në pamundësi, nga inati, s'do të përtonin t'i përvisheshin turmës. Kjo, nga ana e saj, rrinte

në pritje për t'u dyndur sapo midis kordonit të uniformave të shfaqej ndonjë e çarë.

Afër drekës e çara u krijua. Unë s'e mora vesh si ndodhi. Ne ishim në lokal, ku grumbuj djemsh pinin konjak për t'u trimëruar. Edhe Sparti pinte, fytyra i qe skuqur. Më yshti edhe mua. Mbase po ta kisha ndjekur këshillën e tij, im atë do të më priste atë mbrëmje më kot. Por unë nuk doja të trimërohesha me alkool. Nëse në ditën e tretë të sulmit të ambasadave Sparti ende s'qe futur gjëkund, kjo vetëm e vetëm për shkak të pavendosmërisë sime. Një ndjenjë e rëndë prej fajtori më varej si gur në qafë. Pesë vjet pas vdekjes së nënës, im atë kishte vendosur të rimartohej atë verë. Më dukej e pabesë ta braktisja. Nën peshën e kësaj dileme luhatesha edhe në ato çaste kur përmes xhamllëkut të lokalit vura re lëvizjen e turmave në trotuar dhe dyndjen përpara të atyre që po rrinin të shkallët e Kishës.

Lokali u boshatis. Ne u gjendëm midis rrëmujës, një megafon shpërndante thirrjen e egër të dikujt për t'u zmbropsur. Askush nuk ia vari, rryma vazhdoi të na merrte me vete derisa u krijua një kundërrymë. Policët kishin filluar të godisnin turmën e kjo u step. Pastaj zuri të tërhiqej me shpejtësi, sytë më zunë të gjakosur, civilë me pistoleta në dorë, ata shanin, ulërinin dhe ne u gjendëm në lokal përsëri, rreth të njëjtave tryeza, pranë të njëjtave gota të lëna përgjysmë.

Loja e nervave vazhdoi deri pasdite vonë. Atëherë dikush njoftoi se policët ishin tërhequr. Njerëzit e lanë lokalin me mosbesim, një lajm i tillë ishte shpallur shpesh, por kësaj radhe qëllimi i vërtetë. Në krye të rrugës së ambasadave s'dukej këmbë polici, njerëzit nguteshin të shtyheshin në thellësi grupe-grupe, çifte të reja, familjarë me bohçe nëpër duar e fëmijë kalaqafë, lloj-lloj tipash të pistë, të lodhur e të handakosur. U ndava me Spartin para ambasadës gjermane. Ora ishte tetë e mbrëmjes. Në tetë e gjysmë, sipas fjalës, im atë priste të më njihte formalisht me gruan e tij të ardhshme në restorantin e Hotel Tiranës. Unë nuk i thashë Spartit përse po e lija vetëm. Ndërsa ai, i lodhur nga mëdyshjet e mia, nuk e zgjati. Qëndrova aty derisa u hodh në anën tjetër.

Im atë ose nuk e vuri re gjendjen time, në prag të shterimit nervor, ose bëri sikur nuk e vuri re. Më shumë të ngjarë kishte kjo e dyta. U përpoqa të sajoja një buzëqeshje, im atë, heshtazi, po më lutej. Një lutje e pazakontë, jashtë natyrës së tij. Gjërat që i duheshin ai nuk i kërkonte me të lutura, i impononte, siç u imponohej të gjithëve me logjikën dhe fizikun e fuqishëm. Dyzet e tre vjeç, pa asnjë qime floku të rënë, ai mbetej mjaft tërheqës për femrat. Këtë ma kishte pohuar një shoqja ime tani së fundi, në ceremoninë e ndarjes së dëftesave të

maturës. Im atë erdhi të merrte pjesë, shkelte për herë të parë në shkollën time, gjatë viteve të gjimnazit ai s'kishte pasur kurrë probleme me mua dhe në mbrëmjen e lamtumirës shoqja më përsëriti se im atë i qe dukur burrë i pashëm dhe i ngjante një aktori filmi. Ajo përmendi edhe emrin e aktorit dhe shtoi se sikur unë t'i ngjaja tim eti, do të pranonte të shiheshim, ndonëse nuk ia kisha kërkuar diçka të tillë. Megjithatë, tha një të vërtetë: unë nuk i ngjaja tim eti. Jo thjesht sepse ai ishte i zeshkët e unë leshverdhë, ai shtatlartë e unë mezi i vija te supi, sytë e mi të kaltër si të nënës, të tijat të zinj.

Ndoshta këto po mendonte edhe balerina Dizi kur unë ia dola të sajoja buzëqeshjen e duhur dhe zura vend i bindur aty ku më tha im atë, në karrigen bosh pranë tij, në krah të djathtë. Ato çaste doja të merrja arratinë, të fshihesha gjëkund, mundësisht të shkrihesha në vaj, të nxirrja një gulç që më shtrëngonte fytyrën, pastaj të qetësohesha, të vendosja një rregull brenda meje, të vija në peshë veprimet e asaj dite, të mos pendohesha që nuk e kisha kapërcyer dot murin për të kaluar në anën tjetër, atje ku tani ndodhej Sparti e unë s'i bëja dot shoqëri, unë duhej të ndodhesha këtu, në krahun e djathtë të tim eti, përballë vedetës Dizi, e kjo s'më kishte ndonjë borxh, gjendja ime e vajtueshme s'lidhej fare me të.

Im atë më mbushi një gotë me verë. Unë s'kisha pirë kurrë verë, por atë mbrëmje gjithçka ishte e jashtëzakonshme, po më lejoheshin gjëra të ndaluara, siç po më lejohej të ulesha përballë një gruaje të bukur, më saktë një femre të bukur. Unë s'mund ta quaja grua, koncepti grua për mua ishte i veçantë, lidhej me nënën time, me diçka për t'u ndier fëmijë para saj, dhe ajo ishte shumë e re për të qenë nëna ime.

Ajo e nuhati pështjellimin tim, nxitoi të merrte gotën, ta trokiste me mua, pastaj me tim atë, si u mendua pak, të më uronte për mbarimin e maturës. Dhe ktheu një gllënjë verë, e unë s'mund të mos i çoja sytë te bluza e saj e hapur që lejonte shfaqjen e gjinjve, e të përpiqesha të merrja me mend si e gjykonte im atë këtë shkujdesje. Truri im ra befas pre e një loje të rrezikshme, të turpshme, të padenjë: i përfytyrova në një skenë erotike, ndoshta sepse një ditë në shkollë, njëri nga djemtë, në një çast sinqeriteti, kishte pohuar se masturbohej duke përfytyruar balerinën Dizi. Për të shpëtuar nga këto lojëra të trurit zura të pija verë, atë mbrëmje më lejohej, më nxiste dhe im atë, edhe Dizi, e kjo vazhdoi derisa s'di kush prej tyre tha diçka në lidhje me dyndjen e ambasadave. Atëherë pata ndjesinë e një rënieje në boshllëk. Sigurisht, veprimin tim mund ta ndreqja të nesërmen. Të nesërmen mund të merrja të njëjtën linjë autobusi, të

ndaloja në stacionin e Kishës Katolike. Atje gjithçka do të niste nga e para, një ankth nën diellin djegës të korrikut si një arrati në shkretëtirë drejt një të panjohure, e cila rrinte varur në horizont si mirazh.

– Ky është fillimi i theqafjes, – profetizoi im atë, – këta do ta thyejnë qafën shpejt.

Nuk jam i sigurt nëse këto fjalë ai i tha në restorant, kur darkës sonë po i vinte fundi, apo jashtë, në sheshin e zbrazur “Skënderbej”. Por jam i sigurt se Dizi i futi krahun dhe u mbështet pas tij kur dolëm jashtë e unë mendova se ky ishte një veprim i arsyeshëm. Ajo ka frikë mos thyejë qafën, thashë me vete, ka nevojë të mbahet diku, ndryshe nuk do të ndodhej sonte me ne, do të kapej gjetiu dhe vendi më i mirë për t’u kapur tani janë ambasadat. Ndërsa unë e kisha të pamundur të zgjidhja nëse duhej të veproja si Dizi, t’i fusja krahun tim eti, apo të nesërmen, me t’u gdhirë, të orvatesha të mbërrija Spartin. Theqafjen time im atë as që e çonte nëpër mend. Ai s’e dinte sesa lëndohesha që nuk e çonte nëpër mend një theqafje të mundshme timen. Ajo s’lidhej fare me theqafjet për të cilat fliste ai. Theqafja ime ishte vetmia ime. Në atë verë të nxehtë, pas mbarimit të maturës, në pritje të shpalljes së të drejtave të studimit, ndihesha i braktisur, në një udhëkryq të frikshëm, si një copë leckë përballë shpërfilljes vrasëse të të gjithëve, përfshirë tim atë.

Ideja për t'u bashkuar me Spartin të nesërmen në ambasadën gjermane më lindi rrugës, pa mbërritur ende në shtëpi. Në atë orë të vonë të natës linjat e autobusëve nuk punonin.

– Ne s'mund ta lemë Dizin në mes të rrugës, – tha im atë, – dhe për ta shoqëruar në shtëpinë e saj do të duhen nja dy orë vajtje e kthim...

Kështu mendova dhe unë duke parë dorën e tij rreth belit të balerinës, ishte një zgjidhje e logjikshme. Meqë të dyja duart e tim eti ndërkaq ishin zënë me Dizin, m'u duk e natyrshme të gjeja, më në fund, një zgjidhje për veten. E vendosa tek ngjisnim shkallët e pallatit në gjysmerrësirë ku Dizi, ndoshta e rënduar nga vera, ishte varur në krahët e tim eti. Të nesërmen me t'u gdhirë do të shkoja të zija vend te shkallët e Kishës Katolike.

Diçka e papritur përmbysi edhe planet e mia, edhe ato të Spartit.

E papritura mbërriti përmes ziles së telefonit. Ky ndodhej atje ku kishte qenë gjithmonë, në korridor. S'mund të them sa ishte ora dhe prej sa kohësh përpëlitesha në krevat duke u kthyer nga njëri krah në tjetrin, pa mundur të vija gjumë në sy. Muret e ngopura tërë ditën me nxehtësi po e çlironin tani ngadalë në formën e një afshi mbytës. Ndërsa përmes dritares së hapur futej një tjetër afsh, ngarkuar me një frymë turbulluese, që të ndizte dëshira

seksuale. Ndoshta më shumë se vapa e asaj nate, ishte kjo që s'më linte të mbyllja sy. Ndieja nevojën të prekja një trup femre, siç po prekte tani im atë në dhomën ngjitur, në të njëjtin krevat ku kishte fjetur me nënën time, trupin e një gruaje të re. Dhe fajin e kishte pikërisht kjo grua e re. Unë nuk ndodhesha me Spartin por këtu, duke u përpëlitur, me kokën mbi jastëkun e njomur nga djersët, për shkak të saj. Edhe për dridhmat e mia seksuale fajin e kishte ajo. Sikur të mos i mbante të shkopsitura kopsat e bluzës, sytë e mi nuk do të shkonin te gjinjtë e saj dhe fantazia ime nuk do të shturej qysh se qemë ndarë në korridor, kur unë u mbylla në dhomën time e ata në dhomën përbri, e mes nesh ngrihej vetëm një mur, e ky mur ishte i pazoti të më pengonte të kaloja me mend në anën tjetër, të shihja sesi im atë në fillim e zhveshi në mes të dhomës duke i hequr bluzën, sutienat, t'ia rrëshqiste duart nëpër trup, ta merrte në krahë, ta vendoste mbi krevat e të zhyste fytyrën në gjinjtë e saj, e ajo të rënkonte nga vuajtja, pastaj të klithte, pastaj të rënkonte përsëri, e përsëri të klithte.

Ky përfytyrim më sfiliti. Erdhi një çast kur nuk po e dalloja dot në isha fjetur apo zgjuar, ndihesha nën torturën e një dëshire seksuale që nuk çlirohej dot. Kjo zgjati derisa e pashë veten në ceremoninë e ndarjes së dëftesave të pjekurisë, në sallën e madhe të shkollës, ulur

pranë shoqes sime. Atë e quanin Gerta dhe ndjeva sesi Gerta shtrëngohej pas meje, më fuste këmbën e më ngjeshte gjinjtë, e unë ula dorën nën bankë, ia kalova nën fundin e shkurtër xhins, midis kofshëve, dhe vura re se në të vërtetë nuk ndodheshim në sallën e mbledhjeve, s'e mora vesh ku ndodheshim, por ishim vetëm e kësaj herë u nguta. Zura t'i ulja mbathjet e ajo u shtri. Më pëshpëriti se do të më lejonte po të lija mustaqe si im atë, ti s'i ngjan tët eti, tha, nuk je seksi e më në fund me stërmundim arrita ta depërtoja.

Tringëllimën e telefonit në korridor duhet ta kem dëgjuar atë çast. Mendova se vazhdoja të isha në kllapinë time erotike, por shpejt u binda për të kundërtën. Në qetësinë e natës telefoni ulërinte. Nuk lëviza. Nuk prisja ndonjë telefonatë, aq më pak në një orë të tillë, kur dukej sikur gjithçka ishte zhytur në gjumin e vdekjes. Edhe unë doja të zhytesha në një gjumë vdekjeje, diku larg, në një vend ku kllapitë s'do të më mbërrinin dot.

E pamundur. Tjetri këmbëngulte dhe kjo qe çmenduri. Më mirë do të pranoja të hidhesha nga dritarja, sesa t'i nënshtrohesha asaj çmendurie, nervat e mia ishin ende të forta. Duket nuk duruan ato të tim eti. Dera e dhomës së tij u hap, ai doli në korridor, dëgjova zhurmën e ngritjes së receptorit, një hungërimë të përgjumur dhe, së fundi, trokitje në derën e dhomës sime.

– Është për ty, – tha im atë, – të kërkojnë.

Vesha në errësirë pantallonat dhe dola në korridor. Im atë qe kthyer në shtrat. Kur vura receptorin në vesh duke shqiptuar një “alo” të mbytur e kuptova përse ai nuk kishte qëndruar të më kërkonte shpjegime për këtë telefonatë të dyshimtë, në një orë edhe më të dyshimtë: ishte dy pas mesnate. Nga ana tjetër më erdhi një zë i largët vajze e megjithëse ma tha emrin, mezi i rashë në të se ishte Silva, motra e Spartit.

Po qante, e ndjeva menjëherë. Dhe u preva. Nuk mund të mos bëja një lidhje midis dënesës së saj dhe aventurës sonë nga Kisha Katolike.

– Tani, – po më thoshte ajo, – të gjithë janë në spital, babi pësoi infarkt për shkak të Spartit. Ai e di mirë se babi vuan nga zemra, ka vite që vuan e së paku për hir të tij ai s’duhej ta bënte atë që bëri. Se ti ndoshta nuk e di, – shtoi, – të lutem më fal, edhe për bezdinë në këtë orë të papërshtatshme, por Sparti na mori në telefon, është futur në ambasadën gjermane, me gjithë lutjet e mamit ai s’pranoi të kthehej në shtëpi, prej këndeje dal vetëm i vdekur, tha, s’dua më të thith atë ajër të qelbur dhe babi, nga tronditja, pësoi infarkt.

M’u zunë fjalët në grykë. Rashë në një pështjellim të plotë kur dera e dhomës përballë u hap e prej andej doli Dizi, e mbështjellë me një robdëshambër të tim eti. Ajo më buzëqeshi, pastaj u fut në banjë. Nuk e pata në dorë të mos përfytyroja se ajo ishte krejt e zhveshur

nën robdëshambrin e madh. Gruaja e ardhshme e tim eti po urinon, mendova. Pastaj thashë me vete se po bëhesha cinik. Tekefundit, s'ka asgjë të keqe, u shfajësova, bota është cinike. Fjala vjen, në këtë kohë theqafjesh, siç kishte profetizuar im atë, ai ndante shtratin me një vedetë, Sparti s'donte të thithte më këtë ajër të qelbur, i ati i tij qe shtruar në spital me infarkt e unë, me një ndjesi të pështirë, që më përftonin mbeturinat e lagështa të kllapive erotike, dëgjoja i shastisur zërin e Silvës.

Ndërkaq dera e banjës u hap, prej andej doli Dizi, ajo më qeshi përsëri e unë përsëri mendova se ishte krejt e zhveshur nën robdëshambrin e madh. Pastaj u fut në dhomë, përfytyrova sesi e flaku robdëshambrin, i pozoi tim eti trupin e ëndërruar nga shokët e mi masturbues, e tani, për inat të tyre, shtrihej pranë tij për të mos thyer qafën, dhe Silva më lutej ta ndihmoja.

U përpoqa të kap thelbin e lutjes së saj. Kjo do të thoshte të hiqja dorë nga planet e mia, kur të gdhihej të mos orvatesha të çaja me turmat kordonin e policëve në rrugën e ambasadave, të mos kërceja ndonjë mur, megjithëse edhe mua, ashtu si Spartit, ajri që thithja më dukej i qelbur dhe im atë me siguri nuk do të pësonte ndonjë infarkt nëse do të sillësha i përgjegjshëm, pra ta merrja në telefon e t'i njoftoja arratinë time. Ia dhashë fjalën

Silvës pa u menduar shumë, ishte e mundimshme të dëgjoja lutjet e saj për një gjë aq të vogël. Ajo më lutej të shkoja në ambasadën gjermane, jo të mbyllesha dhe unë atje, misioni im ishte të gjeja Spartin, të bisedoja me të, ta vija në dijeni për infarktin e të atit, të bëja çmos t'ia mbushja mendjen të hiqte dorë nga arratia, të gjithë i luteshin, i përgjëroheshin dhe ai s'duhej të sillej mosmirënjohës.

E mbajta fjalën, nga ora dhjetë e asaj dite ia dola të depërtoja deri në ambasadën gjermane. Qëndrova nën diellin vrasës rreth tri orë. Pas tri orësh dikush matanë murit më njoftoi se personi që kërkoja nuk gjendej, ishte larguar në mëngjes, herët.

Duket një lajmëtar tjetër kishte mbërritur përpara meje. Dhe u ktheva mbrapsht.

*M*ë solli në vete një breshëri automa-
tiku. Dizi u drodh, iu shmang vështrimit tim dhe
e braktisi kangjellën me vrap. Breshëria u
pasua nga një e dytë, pastaj ra heshtje.

U ktheva në dhomë si ndër ethe, i vura kyçin
derës. Nuk mund të duroja praninë e askujt.
U kujdesa të mbyllja mirë dhe derën e ballkonit,
zhurmat më shqetësonin, njëlloj si breshëritë e
kallashnikovëve, britma shpirtrash të mallkuar.
E kuptoja nevojën ulëritëse të atyre shpirtrave.
Edhe unë doja të ulërija. Gjyqi do të ishte një
formë ulërime. Pavarësisht se, për paradoks, i
pandehuri do të isha unë dhe të pandehurit e
vërtetë, ata që duheshin mbërthyer në bankën
e turpfit, do të luanin rolin e akuzës, do të
gjykonin krimin tim.

Nuk e kisha të vështirë të ndërtoja palën e akuzës. Po aq i lehtë do të ishte dhe krijimi i një trupi gjykues. Në këto role mund të përshtateshin deputetë, ministra, zëvendës-ministra, qoftë dhe kryeministra. Të përshtatshëm do të ishin gjithashtu kategoria partiake, nisur nga zelli i tyre për të qenë rregullatorë të shoqërisë. Në këtë pozicion ata do të më jepnin pa ngurrim dënimin kapital po të mos i kishin duart të lidhura nga një ligj i cili ua ndalon këtë, sido që nuk ndalon duart e asnjë kriminelit për të vrarë. Pastaj lista e personave të mundshëm në funksionet që thashë mund të zgjatej me elementë të përmasave më modeste, fjala vjen përfaqësues të shtypit.

Më i lehtë do të qe krijimi i jurisë. Nëse lidhur me palën e akuzës dhe trupin gjykues idetë e mia ishin qartësuar deri në shkallën e kategorive, jurinë e përfytyroja imtësisht. Ajo do të formohej me përfaqësues të të dyja klaneve familjare, të krahut tim dhe të krahut të Lindës. Të mitë, me në krye tim atë, do të vendoseshin në të djathtë të tribunës, si pinjollë ish-pronarësh kjo u takonte. Krahut të Lindës i takonte në të majtë, ndonëse s'pranonin të quheshin persekutorë. Atyre vetëm se u kishte pëlqyer ca si shumë gjithçka që u krijonte epërsi mbi të tjerët, fjala vjen një kobure në brez. Por këto tashmë ishin harruar. Rëndësi paraqiste krimi im, për dënimin e tij

do të bashkoheshin të gjithë, edhe akuza, edhe trupi gjykues, edhe juria, sidomos juria. Me gjithë ndërtimin e saj dykrahësh, në rastin tim ajo do të tregohej e njëzëshme, siç qe treguar e njëzëshme gjithmonë kundër meje.

Këtu niste ngatërresa, godina që ngrija shembej si një kështjellë prej rëre. Duhej përcaktuar krimi im. Pa këtë unë s'do të isha në gjendje të provokoja një gjyq ku nga i akuzuar të kthehesha në akuzues. I vetëm kundër të gjithëve, me segmentet e errëta të kujtesës, rob i saj, i lidhur këmbë e duar, i sigurt për dëshirat e mia vrastare, por i pasigurt në kisha vrarë apo jo, as cilin kisha vrarë e për ç'motive. Mbaja mend vetëm revolverin e prodhimit kinez të modelit rus TT. E kisha blerë ato ditë marsi në një qoshe të Pazarit të shkretuar të Gabit, ishte malli i vetëm dhe me çmim fare të lirë e më tutje, për besë do të çmendesha, truri im bllokohej e unë më kot përpiqesha të mos zhytesha e të mos thithesha nga terri i pavetëdijes.

– Ta shpjegova një herë, – dëgjova një zë, – ke ngecur në rrjetën e merimangës virtuale!

Te qoshja e dhomës, ulur në kolltukun pranë reflektorit të ndezur, po rrinte ai, mërdhaci filozof.

– O Zot, – mërmërita, – prapë ky...

– E shoh, vërejt ai, – s'ke besim tek unë. Shpirti të ka ardhur në majë të hundës dhe je

gati të më sikterisësh. Nuk ta këshilloj, ndoshta e gjejmë një zgjidhje. Ti të shpëtosh nga unë e unë të shpëtoj nga ti.

I mërzhitur, i sigurt se tjetri s'do të më shqitej, i thashë:

– Dakord, më propozo një zgjidhje!

Mërdhaci heshti për një çast dhe më ofroi zgjidhjen: vazhdimin e rrëfimit të historisë së tij.

Më erdhi t'i thosha të zhdukej, nuk ia kisha ngenë. Në vend të kësaj, gjithnjë i sigurt se ai nuk do të më shqitej, i thashë përsëri “dakord”. Dhe e dëgjova përdhunshëm, me ngasjen e vazhdueshme për ta ndërprerë, pa e ndërprerë.

“Ka qenë fund nëntori ose fillim dhjetori, – kështu e nisi. – Më saktë mund të përcaktoj vitin: 1981. Isha dhjetë vjeç, Oriana dymbëdhjetë, megjithëse ndiqnim të njëjtën klasë.

E pranoin të gjithë: Oriana ishte e zënë me mua. Informacione të kësaj natyre njoftoheshin mbi muret e WC-ve të djemve. Atje gjeje shënime nga më të pafajshmet, deri te më të ndyrat, sharje nga nënat e motrat, vizatime të organeve seksuale, vajza të zhveshura lakuriq, e plot si këto, zakonisht shënime të nxënësve të klasave të larta. Ne të tjerët i lexonim, zbaviteshim gjatë kohës që kryenim nevojat, të madhen apo të voglën, zbaviteshim më shumë pastaj kur në vend të inicialeve

përdoreshin emrat e plotë, për shembull: “Dje Gjergji ia ka ngritur këmbët Vasilikës”, e ne të gjithë e dinim për cilin Gjergj e për cilën Vasilikë bëhej fjalë, dhe i shihnim tërë kureshtje duke u përpjekur të përfytyronim sesi mund të ishte një ngritje këmbësh. Por kur lexova se çfarë ishte shkruar për mua dhe Orianën në murin e njërës prej WC-ve të djemve, unë nuk u zbavita.

Arsyet për të mos u zbavitur lidhen me diçka tjetër: sapo kishte vdekur xhaxhai, vëllai i madh i tim eti. Jo në shtëpi, as në spital, siç vdesin njerëzit normalisht. Xhaxhai kishte vdekur në burg, e këtu është vendi të sqaroj fatalitetin e parë të jetës sime. Unë nuk mbaj mend që ditëlindjen të ma kenë festuar ndonjëherë në datën e saktë, domethënë më 15 dhjetor të çdo viti. Ajo është festuar gjithmonë një javë më pas e, disa herë, për shkak se binte përpara Vitit të Ri, për të mos bërë shpenzime të tepërta, lihej për natën e festës. Ky ka qenë një shkak i përhershëm grindjesh midis nënës dhe babait. Sepse, siç mësova më vonë, ditën që linda unë, më 15 dhjetor 1971, vëllai i madh i tim eti qe arrestuar.

Me kohë zuri të më mundonte një ndjenjë fajësie sa herë vinte ditëlindja ime. Babai nuk ndodhej i pranishëm në shtëpi atë ditë. Ai shkonte diku larg, në një vend të quajtur Spaç ku mbahej i mbyllur xhaxhai e ku, sipas

bisedave të të rriturve, hyje i gjallë e dilje në arkivol. Kështu doli dhe xhaxhai, në arkivol, e megjithëse ditëlindja ime ishte ende larg, duheshin edhe nja dy muaj të mbushja dhjetë vjeç, unë nuk mund të mos ndihesha fajtor, kësaj radhe jo për burgosjen, por për vdekjen e tij. Këtë mendim ua shfaqta edhe prindërve kur ata u kthyen në shtëpi pas ceremonisë së varrimit. Nëna më tha se po flisja marrëzira.

Atë natë e pushë babanë të dehur për herë të parë e të fundit. Ai nuk pinte. Njerëzit që pinin i përbuzte. Mbase edhe atë natë, pas ceremonisë së varrimit të xhaxhait, babai s'qe dehur. Por ai përmendi dy emra. Në mendjen time dy emrat përfaqësonin diçka të shenjtë, kështu na mësonin në shkollë, portretet e tyre ishin varur në murin e klasës përmbri njëritjetrit. Unë dëgjoja për herë të parë dikë duke i sharë me fjalë të ndyra, dhe ky qe im atë. Kur ai e kuptoi këtë ishte vonë. Dhe u detyrua të më bënte një sqarim. Më kërkoi ta hiqja nga koka idenë se kisha ndonjë faj për vdekjen e xhaxhait.

– Fajtorë për vdekjen e xhaxhait, – sqaroi, – janë të tjerë. Ka ardhur koha ta mësosh e ta fusësh mirë në kokë. Janë ata që, kur unë kisha afërsisht moshën tënde, mbyllën në burg tët gjysh, domethënë tim atë. Ia grabitën pasuritë dhe e torturuan për vdekje. Pastaj e nxorën prej andej me arkivol.

Nëna iu lut të pushonte. Në lutjen e saj kishte diçka të frikshme. Sa më shumë fliste babai aq më e lemerisur dukej ajo. E mua më erdhi keq, nuk e kuptoja përse babai këmbëngulte të m'i thoshte këto. Pastaj diçka arrita të merrja me mend kur ai e mbylli ligjëratën ndaj meje me ca këshilla në formë porosie, e unë mendova se po më lexonte paragrafët e ndonjë libri të shenjtë:

– Ti s'do t'i harrosh këto sa të jesh gjallë. Kur të vijë koha t'ua thuash fëmijëve të tu, pastaj fëmijëve të fëmijëve të tu e kështu me radhë... Dhe çka dëgjove prej meje t'i mbash për vete. Po nuk i mbajte, unë do të përfundoj atje ku kanë përfunduar gjyshi e xhaxhai yt, e ti e di se prej andej del vetëm me arkivol. Ti nuk do që unë të dal prej andej me arkivol.

Të nesërmen, në pushimin midis orëve, pashë shënimin për mua dhe Orianën në murin e njërës prej WC-ve të djemve: “Oriana dhe Ergysi duke u puthur”. Sipër shënimit, një shkarravinë. Nxora nga xhepi shaminë, i fshiva dhe u ktheva në klasë.

Banka jonë ndodhej në fund të rreshtit të majtë, pranë dritares. Në mot të kthjellët e rrihte dielli dhe ajo ishte një ditë e ngrohtë tetori. Ja nga trullosja e diellit, ja nga zëri i mbytur i mësueses, po më kaplonte një përgjumje. Do të përgjumesha sikur të mos ndieja një ngacmim. Gjatë tërë kohës më

mbanin mbërthyer pa më lënë të qetë dy portretet pranë njëri-tjetrit në murin përballë.

Vetëm njëri më shihte. Tjetri, me syze optike, vështronte diku, përtej dritares. Vështrimi i të parit më depërtonte me një butësi prej perëndie, sikur donte të më pyeste nëse ai, perëndia, vërtet më dukej ngrënës njerëzish. Tjetri s'e çante kokën ç'mendoja, ishte xhelat apo kasap, apostull apo ujk. Atij aq i bënte përderisa s'm'i hidhte sytë fare. Kjo më shtyu të tregohesha vigjilent. Nuk duhej t'i thosha as me mendje emrat e tyre prej perëndish të shpallura. Isha zotuar solemnisht me vete, unë s'doja që im atë të dilte prej diku me arkivol. Këtë u thashë portreteve, atij që më shihte dhe atij që s'm'i hidhte sytë.

Portretet nuk e vunë ujët në zjarr. Atëherë më lindi ideja të krijoja një mënyrë komunikimi me ta dhe mënyra më e mirë do të ishte t'u gjeja emra të përshtatshëm. Jo perëndish, as njerëzish të zakonshëm. Meqë sipas babait ata bënë pjesë në kategorinë e antropofagëve, të parin e quajta Ciklopi i Madh. Të dytin Ciklopi i Vogël. Kur ua komunikova, ata përsëri nuk e vunë ujët në zjarr. Njëri vazhdoi të më shihte me butësi prej perëndie, tjetri s'm'i hodhi sytë.

Në komunikimin tim me portretet, ishte e pamundur të profetizoja se njëri prej tyre i kishte ditët të numëruara. Të merrja me mend se Ciklopi i Madh me pamje perëndie, do t'ia hante kokën Ciklopit të Vogël, ndonëse në

murin e klasës rrinin tërë kohën paqësisht pranë njëri-tjetrit. Deri atëherë unë s'kisha dëgjuar apo lexuar gjëkund as shprehjen “ia hëngri kokën”. Përfytyro ç'pamje! Jo një mace duke ngrënë kokën e një miu, as një ujk kokën e një lepuri. Një ciklop duke ngrënë kokën e një ciklopi! Ky përfytyrim më lemerisi një mbrëmje, tek rrinim familjarisht përpara televizorit dhe në ekran u shfaq portreti i Ciklopit të Vogël. Spikeri tha se ai nuk jetonte më, kishte vlarë veten. Nënës i shpëtoi një klithmë. Babai kërceu përpjetë me pamjen e njeriut që nuk u beson as syve, as veshëve. Dhe formuloi atë shprehjen kanibaleske të ngrënies së kokës.

– Nuk e besoj të ketë vlarë veten, – tha, – s'ishte tip që vret veten. Atij ia kanë ngrënë kokën!

Pastaj, si këputi një të sharë, shtoi:

– Tani të madhit i mbetet të hajë kokën e vet, s'ka ç'të hajë tjetër, i mbaroi të gjitha kokat!

Atë natë pashë në ëndërr Ciklopin e Madh duke ngrënë kokën e Ciklopit të Vogël.

Edhe Oriana kishte parë të njëjtën ëndërr. Si zakonisht e prita poshtë shkallëve, ajo zbriti pas meje dhe rrugën deri në shkollë e bëmë në heshtje. Sytë e saj ishin të skuqur. Sytë e Orianës skuqeshin kështu kur hante ndonjë flakërimë e kjo ndodhte kur i ati e zinte me detyra të pabëra. Ndieja një këputje të madhe